



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

RELACION

PËR

**PROJEKTVENDIMIN “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË KOMPENSIMIT TË DREJTË PËR PËRDORIMIN E VEPRAVE PA AUTOR”**

**I. QËLLIMI I VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëlliimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të qarta për të kompensuar në mënyrë të drejtë autorin ose bashkautorin, për përdorimet e veprave të tyre, për periudhën kur statusi i këtyre krijuimeve intelektuale ishte “vepër pa autor”.

Nëpërmjet këtij vendimi synohet të ruhet një balancimin i të drejtave të krijuvesve në raport me krijuimet intelektuale të tyre dhe interesave të institucioneve përfituese që digitalizojnë arkivat e tyre, ku bëjnë pjesë dhe veprat pa autor, për të realizuar misionet e tyre me interes publik, si përhapja e kulturës. Projektvendimi vë në dukje detyrimin për të garantuar transparencën dhe garantimin e zbatueshmërisë së ligjit për të drejtat e autorit, si dhe siguron shpërblimin e krijuvesve.

**II. VLERËSIMI I VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor” është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare për reformën ligjore për të drejtën e autorit, e cila nisi me miratimin e ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar (me ligjin nr. 37/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”) (në vijim ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar).

Ky projektvendim është në përputhje me programin e Këshillit të Ministrave për projekt aktet e Ministrisë së Kulturës për vitin 2023, miratuar me vendimin nr. 862, datë 27.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analistik të Projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”

Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi, në përputhje me fushën e veprimtarisë shitetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin në fushën e të drejtës së autorit.

### III. ARGUMENTIMI I VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Veprat pa autor në Republikën e Shqipërisë i i përkasin një kategorie krejtësisht të re për Republikën e Shqipërisë në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to dhe për këtë arsy që vendim propozon një procedurë të thjeshtë dhe lehtësishët zbatueshme në lidhje me kompensimin e drejtë për përdorimin e veprave pa autor për të gjithë palët e përfshira në proces.

Autori ose bashkautori mund t'i jepin fund në çdo kohë statusit “vepër pa autor”. Në këto raste, institucioni i cili ka përdorur veprën do të kompensojë për përdorimet e veprave pa autor, autorin ose bashkautorin të cilët/ve i përkasin, pavarësisht nga natyra e përdorimit të veprës, nëse ka përfituar finansiarisht nga ky përdorim, apo edhe nëse ka kryer kërkimin shteres përparrë përdorimit. Ky vendimi propozon që autori ose bashkautori individualisht ose përmes përfaqësuesve, të paraqesin një kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin e duhur, për të filluar procedurën e kompensimit të drejtë për përdorimin e veprës pa autor, vetëm në përfundim të procedurës së ndërrprerjes së statusit “vepër pa autor”.

Sqarohet se nuk ka një model të vetëm të procedurës së dhënies fund të statusit “vepër pa autor” në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Baza ligjore Evropiane e cila rregullon këtë fushë, që është përafshuar në ligjin për të drejtën e autorit, i jep lirshmërinë çdo vendi të vendosë mënyrën dhe procedurën e saj. Referuar studimeve të Bashkimit Evropian në lidhje me zbatimin e këtyre dispozitave në praktikë nga vendet anëtare, një autor i një vepre pa autor shfaqet rrallë, megjithatë vendet të cilat kanë një procedurë të mirë përcaktuar kanë më shumë rezultat se ato që nuk e kanë një të tillë.

Vendet si Italia, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Finlanda, Franca dhe Greqia, të cilat janë marrë dhe referencë për hartimin e këtij kapitulli të vendimit, kanë pasur sukses me procedurën e përfundimit të statusit “vepër pa autor”. Procedura për t'i dhënë fund këtij statusi fillon me paraqitjen e një kërkesë me shkrim e cila shoqërohet me dokumente provues, në zbatim të detyrimit ligjor për të provuar faktet mbi të cilat kërkuesi bazon pretendimin e tij. Për këtë arsy, mungesa e njërit prej dokumenteve sipas vendimit çon në refuzimin e kërkesës. Për të garantuar transparencën dhe përditësimin e informacionit në lidhje me statusin e veprës për përdorime të tjera të mundshme, në kohën e miratimin të kërkesës institucioni njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për të drejtën e autorit për të përditësuar bazën e të dhënave për veprat pa autor. Gjithashtu, në rast të refuzimit të përfundimit të statusit vepër pa autor dhe të fillimit ose jo të

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”

procedurës së kompensimit të drejtë duhet të njoftohet menjëherë ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit. Në rast se institucionet refuzojnë kërkesën për të përfunduar statusin e veprës pa autor, autori ose bashkautori ka mundësinë t'i drejtohet strukturave të tjera për të kundërshtuar vendimmarjen e institucionit në lidhje me mos përfundimin e statusit vepër pa autor, sipas legjislacioneve në fuqi.

Me përfundimin e statusit “vepër pa autor” çdo përdorim tjetër i veprave do të jetë objekt i zbatimit të ligjit për të drejtën e autorit, në kuptim të pajisjes me autorizim për përdorim dhe shpërblimin për çdo përdorim të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Ligji për të drejtën e autorit në tërësinë e tij reflekton fryshtat e bashkëpunimit mes palëve kryesore të përfshira në procese të caktuara, përfundimi i të cilave është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta. Për shembull, agjencitë e administrimit kolektiv (në vijim AAK) përfaqësojnë mbajtësit e të drejtave përmes marrëveshjeve mes tyre; përmes marrëveshjeve të përbashkëta AAK-të përfaqësojnë interesat e mbajtësve të të drejtave ndërkombëtarë; AAK-të përmes një marrëveshje të përbashkët me përdoruesit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to vendosin mbi tarifat e shpërblimit të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Gjithashtu, forma e bashkëpunimit ishte baza e drejtimit të sportelit unik për mbledhjen e të ardhurave të të drejtave të autorit. Arsyja kryesore pse ligji i të drejtës së autorit parashikon marrëveshjen si formë bashkëpunimi, është për të garantuar përfshirje të gjerë të autorit ose bashkautorit në procese vendimmarrëse ku objekt janë të drejtat e tij.

Të gjitha vendet e Bashkimit Evropian kanë parashikuar kompensimin e drejtë të autorit ose bashkautorit në legjislacionet e tyre. Shumica prej tyre<sup>1</sup> propozojnë që intitucionet të cilat kanë përdorur veprat pa autor të vendosim me marrëveshje mes tyre shumën e shpërblimit duke u mbështetur tek kriteret e përcaktuara më parë që kanë të bëjnë me qëllimin e përdorimit, dëmet e mundshme për autorin ose bashkautoren dhe shpenzimet e kryera nga institucioni për digjitalizimin, katalogimin, komunikimin në publik, etj.

Duke respektuar fryshtat e ligjit për të drejtën e autorit, duke mbajtur në vëmendje fushën krejtësisht të re të veprave pa autor si për mbajtësit e të drejtave ashtu edhe për institucionet përdoruese, duke mbajtur në vëmendje qëllimin e përdorimit të veprave nga institucionet e përcaktuara nga ligji, në referencë të sistemeve të shteteve të Bashkimit Evropian në lidhje me kompensimin e drejtë<sup>2</sup>, duke mbajtur në vëmendje që institucionet administrojnë vepra që nuk janë në përdorim publik prej dekadash, ky vendim propozon që institucionet të cilat përdorin veprat pa autor, të përcaktojnë shumën e kompensimit të drejtë në konsultim me autorin dhe bashkautoren për të garantuar përfshirjen e krijuesve në procesin vendimmarrës, duke marrë

<sup>1</sup> Italia, Greqia, Franca, Gjermania, Hollanda, Cekia, Polonia, Rumania, Spanja, Qipro, Finlanda, Kroacia, Irlanda, Luksemburgu, Malta, , Portugalia, ,Slovakia dhe Mbretëria e Bashkuar.

<sup>2</sup> Studim i Komisionit Evropian për zbatimin e Direktivës për përdorimin e veprave pa autor, Prill 2021, Faqe 75;file:///C:/Users/borana.ajazi1/Doenloads/study%20on%20the%20application%20of%20the%20orphan%20works%20directive-KK0521084ENN%20(3).pdf

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”

parasysh duke marrë parasysh që përdorimi i veprave pa autor është në funksion të realizomit të funksionit publik.

Ky vendim nuk propozon shuma konkrete të kompensimit pasi përdorimi i veprave pa autor është i ndryshëm nga përdorimi i veprave me autor. Siç është përmendur më sipër, në përcaktimin e shumave të kompensimit rol kryesor luan qëllimi i përdorimit, i cili është tërësisht jo fitimprurës. Gjithashtu, veprat pa autor mund të mos jenë shfaqur në publik prej vitesh dhe vlera e tyre është e vështirë të përcaktohet. Institucionet e përcaktuara në ligj në shumicën e rasteve rrisin vlerën e këtyre veprave duke i ekspozuar dhe vënë në dispozicion të publikut në forma të ndryshme. Për këtë arsyе përcaktimi i shumës së kompensimit do të përcaktohet me studim rast pas rasti.

Në Bashkimit Evropian vetëm 4 (katër) shtete, Franca, Lituania, Sllovenia dhe Hungaria propozojnë shuma konkrete të kompensimit të autorëve; vetëm pasi nuk është arritur marrëveshje mes palëve. Në këto shtete kompensimi do të përcaktohet me marrëveshje mes palëve dhe do të llogaritet në bazë të humbjeve konkrete të autorit për shkak të përdorimi të veprës së autorit. Përshebull në Hungari, shumat e kompensimit janë të përcaktuara me saktësi si më poshtë: (a) në rastin e veprave letrare, 3,000 forintë hungareze (HUF) për faqe autorësh; (b) në rastin e veprave poetike, 10 HUF për varg; (c) në rastin e krijimeve kinematografike dhe veprave të tjera audiovizuale, 100 HUF për minut etj. Në Lituani, shuma e kompensimit përcaktohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar nga qeveria, në bazë të rekomandimit të ekspertëve për kompensimin e veprave pa autor, i cili nuk mund të tejkalojë shumën e 10 të ardhurave sociale, etj.

Për sa më sipër ky vendim nuk mund të propozojë kosto financiare, pasi përcaktimi i shumës së kompensimit për veprat pa autor do të jetë vendimmarje rast pas rasti.

Autori ose bashkaurori i rishfaqur së bashku me kërkесën për të përfunduar statusin “vepër pa autor” shpreh dhe interesin për kompensim ose jo për përdorimet e veprës së tij. Pas marrjes së kërkësës institucionet përcaktojnë shumën e kompensimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkësës.

Në mungesë të një vendimi, institucionet që kanë përdorur veprën do të përcaktojnë shumën e kompensimit bazuar në metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, duke ju referuar të njëjtës kategori veprash, Metodologja dhe tarifa e shpërblimit është e njëjta sipas referencës së ligjit për të drejtën e autorit nr. 135/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”

Në çdo rast palët duhet të mbajnë në vëmendje dhe të konsiderojnë qëllimin publik të përdorimit të veprave pa autor i cili sqarohet i detajuar në ligjin për të drejtën e autorit, kohën e përdorimit të veprave pa autor, dëmin real të shkaktuar autorit ose bashkautorit dhe shpënzimet e kryera nga institucionet për të realizuar funksionin e tyre publik.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 75/2, të ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar i cili ngarkon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar (Acquis Communautaire).

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË VENDIMIT**

Ky projektvendim është i përbërë nga 20 pika, me përbajtje si më poshtë:

**Pika 1**, përcakton objektin e projektvendimit.

**Pika 2**, saron përkufizimet e termave kryesore që përdoren në vendim.

**Pika 3**, përcakton se për t'i dhënë fund statusit të veprës pa autor është e nevojshme paraqitura e një kërkesë me shkrim nga autori, bashkautori ose agjencia e administrimit kolektiv e autorizuar prej tij/tyre pranë bibliotekave me akses publik, institucioneve arsimore dhe muzeve, personave të tjerë juridike që kryejnë veprimtari muzeore, arkivave, institucioneve arkivore filmike ose audiovizuale dhe transmetuesit publikë që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë (pika 2, e nenit 16/2 të ligjit nr. 35/2016, I ndryshuar).

**Pika 4**, përcakton dokumentacionin e nevojshëm me të cilin duhet të shoqërohet kërkesa e përcaktuar në pikën 3.

**Pika 5**, parashikon se kushtet e pikës 4 janë kumulative dhe mungesa e njërit prej dokumenteve sjell refuzimin e kërkesës.

**Pika 6**, përcakton afatin e shqyrimit të kërkesës përfundimin e statusit të veprës pa autor nga ana e institucioneve të pikës 3 të vendimit.

**Pika 7**, parashikon detyrimin e institucionit, që shqyrton kërkesën, përfundimin e menjëherëshëm të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit përfundimin e statusit veprë pa autor dhe fillimin ose jo të procedurave përkompensimin e drejtë.

**Pika 8**, parashikon detyrimin e ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit përditësimin e bazës së të dhënave për veprat pa autor.

Pika 9, sqaron se pas përfundimit të statusit vepër pa autor, institucioni përdor veprën vetëm me autorizim/kontratë me shkrim të autorit, bashkautorit apo titullarit të të drejtave të veprës origjinale.

Pika 10, përcakton se procedura për kompensimin e drejtë për përdorime të veprave pa autor nis me kërkesë me shkrim të autorit, bashkautorit ose agjencisë së administritimit kolektiv, të autorizuar prej tij.

Pika 11, sqaron mënyrën e përcaktimit të shumës së kompensimit të drejtë mënyrën e shpërblimit, sipas konsultimit midis autorit ose bashkautorit dhe institucioneve të pikës 3 të vendimit.

Pika 12, parashikon se kriteret mbi të cilat përcaktohet shuma e kompensimit të drejtë midis palëve.

Pika 13, përcakton afatin e përfundimit të vendimmarrjes sipas pikës 11 dhe përllogaritjen e shumës së shpërblimit.

Pika 14, përcakton institucionin që kryen kompensimin.

Pika 15, sqaron mënyrën e kompensimit kur vepra është në bashkautorësi.

Pika 16, parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë.

Pika 17, parashikon institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit.

Pika 18, parashikon hyrjen në fuqi të vendimit.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Referuar dispozitave të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, për shkak të fushës së zbatimit të së drejtës së autorit dhe mbrojtjes, dhe me qëllim zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij vendimi, institucionet që përfshihen në zbatimin e këtij projektvendim janë Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, Bibliotekat publike shtetërore dhe bibliotekat publike private; muzetë në Republikën e Shqipërisë; institucionet e ndryshme arkiv krijuese që zbatojnë dispozitat e depozitimit të detyrueshëm të kopjeve të ligjshme të krijimeve, të publikuara/të prodhuara ose të importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë; institucionet arkivore filmike ose audiovizuale; transmetuesit publik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, agjencitë e administritimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve të të drejtës së autorit;

## VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i këtij projektvendimi është bërë nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor”

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE  
BUXHETORE

Hyrja ne fuqi e këtij vendimi nuk shoqërohet me efekt financiar për buxhetin e shtetit.

X. HYRJA NË FUQI E KËTIJ VENDIMI

Ky vendim do të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
ELVA MARGARITI

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor"